Paneli këshillëdhënës për të drejtat e njeriut
Building D, UNMIK HQ, Prishtinë/Kosovë | E-mail: hrap-unmik@un.org | Tel: +381 (0)38 504-604, ext. 5182

**VENDIM**

**Data e miratimit: 23 gusht 2012**

**Lënda nr. 283/09**

**Predrag JOKSIMOVIÇ**

**kundër**

**UNMIK-ut**

Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut, i mbledhur më 23 gusht 2012,
me anëtarët vijues të pranishëm,:

Z. Marek NOWICKI, Kryetar
Z. Paul LEMMENS
Znj. Christine CHINKIN

Të ndihmuar nga
Z. Andrey ANTONOV, zyrtar ekzekutiv

Pas shqyrtimit të ankesës së sipërpërmendur, të paraqitur në pajtim me nenin 1.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 të datës 23 mars 2006 për themelimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut,

Pas diskutimeve vendosi si në vijim:

## I. PROCEDURA PRANË PANELIT

1. Ankesa u parashtrua më 3 prill 2009 dhe u regjistrua më 30 prill 2009.

2. Më 23 dhjetor 2009, Paneli kërkoi informacione shtesë nga ankuesi. Paneli nuk mori asnjë përgjigje lidhur me këtë kërkesë.

3. Më 4 prill 2012, Paneli ia komunikoi rastin Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) për komentet e UNMIK-ut mbi pranueshmërinë e rastit. Më 3 maj 2012, PSSP-ja e ofroi përgjigjen e UNMIK-ut.

## II. FAKTET

4. Ankuesi është djali i z. Momçilo Joksimoviç.

5. Ankuesi thekson se më 7 nëntor 1999, z. Momçilo Joksimoviç ishte rrëmbyer diku në mes të fshatit Vragoli dhe fshatit Batushë në komunën e Fushë Kosovës.

6. Ankuesi deklaron se rrëmbimin e kishte raportuar në Komitetin Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq (KNKK), në Kryqin e Kuq të Serbisë, në KFOR dhe në UNMIK. Mbetjet mortore të babait të tij më vonë u gjetën më 16 nëntor 1999 në rrugën ndërmjet Mitrovicës dhe Drenicës. Ankuesi thekson se shkaku i vdekjes ishin të shtënat me armë në kokë. Në kopjen e certifikatës së vdekjes të përgatitur nga UNMIK-u më 19 prill 2000 thuhet se shkaku i vdekjes ishte vrasje pa dashje.

7. Më 9 dhjetor 2008, përgjegjësia e UNMIK-ut lidhur me gjyqësorin në Kosovë përfundoi me marrjen e kontrollit të plotë operacional nga Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX) në fushën e sundimit të ligjit, pas deklaratës së bërë nga Kryetari i Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara më 26 nëntor 2008 (S/PRST/2008/44), duke përshëndetur angazhimin e vazhdueshëm të Bashkimit Evropian në Kosovë. Ndërmjet 9 dhjetorit 2008 dhe 30 marsit 2009, të gjitha dosjet e lëndëve penale të cilat mbaheshin nga Departamenti i Drejtësisë së UNMIK-ut dhe nga Policia e UNMIK-ut iu dorëzuan homologëve të tyre në EULEX.

## III. ANKESA

8. Ankuesi ankohet për siç pohon dështimin e UNMIK-ut që të hetojë si duhet rrëmbimin dhe vrasjen e babait të tij.

9. Paneli mendon se ankuesi mund të konsiderohet se thirret në shkelje të së drejtës së babait të tij për jetë, të garantuar me nenin 2 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ).

## IV. LIGJI

10. Para se të shqyrtohet rasti për bazueshmërinë e tij, Paneli së pari duhet të vendosë nëse do ta pranojë rastin, duke marrë parasysh kriteret për pranim të përcaktuara në nenet 1, 2 dhe 3 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12.

11. Ankuesi pohon në esencë mungesën e një hetimi penal adekuat për rrëmbimin dhe vrasjen e babait të tij.

12. Në komentet e tij, PSSP-ja argumenton se meqë mbetjet mortore të z. Momçilo Joksimoviç ju dorëzuan familjes së tij nëntë ditë pas zhdukjes së tij, UNMIK-u veproi në përputhje me njërën nga kushtet procedurale të parapara në nenin 2 të KEDNJ, përkatësisht obligimin për të zbatuar një hetim përmes të cilit do të përcaktohej fati dhe vendndodhja e personit të zhdukur. PSSP-ja është i mendimit se ankesa lidhur me aspektin e lartcekur të nenit 2 është e papranueshme.

13. Në anën tjetër, PSSP-ja pranon se ankesa është e pranueshme në shikim të parë sa i përket një kërkese tjetër procedurale të nenit 2 të KEDNJ, përkatësisht obligimin për të zbatuar një hetim nga rezultatet e të cilit do të vendosej "nëse vdekja ishte e paligjshme" dhe kjo të shpinte në identifikimin dhe dënimin e atyre që ishin përgjegjës për zhdukjen dhe/ose vdekjen e z. Momçilo Joksimoviç.

14. Paneli thekson se PSSP-ja bën dallimin në mes të dy kushteve procedurale të nenit 2 të KEDNJ. Ai pra konsideron se aktivitetet për gjetjen dhe identifikimi e mbetjeve mortore të një personi të zhdukur mund të shihen si komponentë e pavarur nga obligimi procedural i paraparë në nenin 2 të KEDNJ.

15. Për këtë çështje, Paneli i referohet praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut që cakton standardet për një hetim efektiv për vrasjet dhe zhdukjet në rrethana kërcënuese për jetën. Gjykata Evropiane thekson se "qëllimi kryesor i një hetimi të tillë është të sigurojë implementimin efektiv të ligjeve vendore që mbrojnë të drejtën për jetë ..." (shih, p.sh. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) (Grand Chamber), *Varnava dhe të Tjerët kundër Turqisë*, nr. 16064/09 dhe të tjerë, aktgjykim i 18 shtatorit 2009, § 191). Në mënyrë më specifike, sa u përket personave të pagjetur të cilët më vonë zbulohet se janë të vdekur, Gjykata ka deklaruar se procedurat e zhvarrosjes dhe identifikimit të mbetjeve mortore nuk e shterojnë obligimin sipas nenit 2 të KEDNJ. Është e vërtetë se Gjykata konsideron se "obligimi procedural si pasojë e zhdukjes në përgjithësi do të mbetet për aq kohë sa vendndodhja dhe fati i personit mbeten të pashpjegueshme, dhe kjo është një gjendje e vazhdueshme" (GJEDNJ, *Paliç kundër Bosnjës dhe Hercegovinës*, nr. 4704/04, aktgjykim i 15 shkurtit 2011, § 46; në kuptimin e njëjtë GJEDNJ (Grand Chamber), *Varnava dhe të Tjerët kundër Turqisë*, cituar lart, në § 148). Mirëpo, Gjykata po ashtu thekson se këtij obligimi procedural "nuk i vjen fundi edhe pas zbulimit të trupit .... Kjo vetëm hedh dritë në një aspekt të fatit të personit të zhdukur, dhe obligimi për të shpjeguar zhdukjen dhe vdekjen, si dhe për të identifikuar dhe ndjekur ndonjë keqbërës për veprime të paligjshme në lidhje me rastin, në përgjithësi do të mbesin" (GJEDNJ, *Paliç kundër Bosnjës dhe Hercegovinës*, cituar lart, në § 46; në kuptimin e njëjtë GJEDNJ (Grand Chamber), *Varnava dhe të Tjerët kundër Turqisë*, cituar lart, në § 145). Prandaj, obligimi procedural sipas nenit 2 të KEDNJ duhet parë si obligim i veçantë. Derisa gjetja dhe identifikimi i mëvonshëm i mbetjeve mortore të viktimës mund të jenë të arritura të rëndësishme, obligimi procedural sipas nenit 2 vazhdon të ekzistojë (shih GJEDNJ, *Paliç kundër Bosnjës dhe Hercegovinës*, cituar lart, në § 64).

16. Për këto arsye, Paneli nuk do ta ndajë obligimin për të zbatuar hetim përmes të cilit do të përcaktohej fati dhe vendndodhja e personit të zhdukur nga obligimi për të zbatuar një hetim për të konstatuar nëse ka pasur zhdukje të paligjshme, dhe i cili hetim do të na shpinte në identifikimin dhe dënimin e atyre që janë përgjegjës për zhdukjen dhe vdekjen e viktimës. Paneli do të procedojë në bazë të obligimit të vetëm të vazhdueshëm (shih Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut (HRAP), *Simoviç*, nr. 246/09, vendim i 6 prillit 2012, § 18). Mirëpo, siç duket qartë, fakti se mbetjet mortore të z. Dimitrije Milenkoviç dhe z. Aleksandar Milenkoviç janë gjetur dhe më vonë janë identifikuar, është një element i rëndësishëm që duhet marrë parasysh në vlerësimin e gjithëmbarshëm të përmbushjes së obligimit procedural sipas nenit 2 të KEDNJ.

17. Prandaj, Paneli konsideron se ankesa ngrit çështje serioze faktike dhe juridike, vendosja e të cilave do të duhej të varet nga shqyrtimi i bazueshmërisë. Prandaj, Paneli konkludon se

ankesa nuk është e pabazuar në shikim të parë në kuptim të nenit 3.3 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12.

18. Arsye tjetër për shpalljen e ankesës të papranueshme nuk është konstatuar.

**PËR KËTO ASRYE,**

Paneli unanimisht,

**SHPALL ANKESËN TË PRANUESHME.**

Andrey ANTONOV
Zyrtar ekzekutiv

Marek NOWICKI
Kryetar